



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2467/11 prot.

Datë 14.12.2023

**V E N D I M**

**Nr. 1306/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.12.2023 shqyrtoi kërkesën me:

**Objekt:**

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. **REF-77239-08-10-2023**, me objekt **Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje Tuba dhe Materiale konsumi laboratorike për nevoja të SRV” ndarë në 2 (dy) Lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, Loti 1 REF-77241-08-10-2023, Loti 1 “Blerje tubave/sistemeve të marrjes së gjakut” (në zbatim të kontratës koncesionare të laboratorëve)**, me fond limit Loti 1: 5,539,950 (Pesë milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.

Vazhdim i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës së operatorit ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ALMedical” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Lënien të skualifikuar si edhe shtim të arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK

**Ankimues:**

“Distributor of Medical Devices Group” SHPK me NIPT L81422033E dhe adresë *Adresa: Njësia nr. 8, Rruga “Siri Kodra”, Objekti nr. 198-Tiranë.*

Operatori ekonomik “ALMedical” SHPK me NIPT K21511002I dhe adresë *Adresa: Rruga “Shefqet Musaraj”, Banesa nr. 17, Tiranë*

**Autoriteti Kontraktor:**

Spitali Rajonal Vlorë  
*Adresa: Lagjja “Partizani”.*

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V e r e n:**

**I**

## *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## **II**

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 11.08.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. **REF-77239-08-10-2023**, me objekt **Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër:** “Blerje Tuba dhe Materiale konsumi laboratorike për nevoja të SRV” ndarë në **2 (dy) Lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj**”, **Loti 1 REF-77241-08-10-2023, Loti 1** “Blerje tubave/sistemeve të marrjes së gjakut” (**në zbatim të kontratës koncesionare të laboratorëve**), me fond limit Loti 1: 5,539,950 (Pesë milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.

II.2. Në datën 25.09.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 03.10.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- |  |                                 |
|--|---------------------------------|
| 1. “ALMedical” SHPK                            | 4,650,500.00 lekë, skualifikuar |
| 2. “Distributor of Medical Devices Group” SHPK | 3,489,757.00 lekë, skualifikuar |
| 3. “KRIJON” SHPK                               | nuk ka oferte, skualifikuar     |

II.4. Në datën 05.10.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Publikimi i Njoftimit të anulimit” për procedurën e prokurimit të sipërcituar, si dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr. 84, datë 09.10.2023.

II.5. Në datën 09.10.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi A/2023/3479 dhe me nr. 2467/2023 prot., datë 09.10.2023 e operatorit ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK, ku konstatohet se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 2467/2 prot., datë 10.10.2023, arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK.

II.5.2. Në datën 13.10.2023 ka ardhur në sistem Formulari i paraqitjes së argumenteve nga operatori ekonomik “ALMedical” SHPK protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 2467/3 prot., datë 13.10.2023.

II.5.3. Me anë të shkresave me Nr. 4022 prot., datë 12.10.2023 dhe me nr. 4024 prot., datë 12.10.2023, protokolluar pranë institucionit tonë me Nr. 2467/4 prot., datë 17.10.2023 dhe me nr. 2467/5 prot., datë 17.10.2023, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe aktin e trajtimit me nr. 3994 prot., datë 11.10.2023 të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Distributor of Medical Devices Group” SHPK, në të cilën është vendosur **pranim i pjesshëm të ankesës**.

II.5.4. Referuar kthimit të përgjigjes së autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka pranuar pretendimin nr. 4 të operatorit ekonomik ankimues “Distributor of Medical Devices Group” SHPK, si më poshtë:

*“Për sa i përket pikës së 4-të të ankesës mbi kodin UMDNS dhe kodin e artikullit HN22G32, pretendimi ankimuesit **pranohet**”.*

II.5.5.Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se janë paraqitur argumente në kuptim të nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” nga operatori ekonomik “ALMedical” SHPK, por ai nuk ka ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti kontraktor mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK dhe për këtë fakt bazuar në nenin 115, pika 2 të LPP-së, në të cilin përcaktohet se: *“Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1, të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim*

*deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër”.*

Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar dhe do të vazhdojë shqyrtimin për pjesën tjetër të ankesës për procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.5.6. Për shkaqe të nevojshme për verifikim, në përputhje me dispozitën e nenit 115, pika 5 e ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, me shkresën nr. 2467/6 prot., datë 31.10.2023, Komisioni i Prokurimit Publik vuri në dijeni autoritetin kontraktor dhe operatorin ekonomik për shtyerje afati në shqyrtimin e ankesës

II.5.7. Me shkresën nr. 2467/7 prot., datë 31.10.2023, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi informacion autoritetin kontraktor Spitali Rajonal Vlorë.

Bazuar në nenin 113 dhe 114 pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” kërkohet të na informoni për sa më poshtë:

- 1. A e keni njoftuar operatorin ekonomik “ALMedical” SHPK mbi vendimmarrjen e autoritetit tuaj kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK? Nëse po, ju lutem të na dërgoni kopje të librit të protokollit që vërteton njoftimin.*
- 2. Nëse nuk e keni njoftuar operatorin ekonomik “ALMedical” SHPK, të merren masa për njoftimin e tij mbi vendimmarrjen e autoritetit tuaj kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK, si dhe të dërgohet kopje të librit të protokollit që vërteton njoftimin.*

II.5.8. Përmes komunikimit elektronik zyrtar KPP iu drejtua me kërkesën për informacion kompanive prodhuese “**Syntesys SRL**”, “**HEINZ HERENZ MEDIZINALEDBARF GMBH**” dhe “**YANGZHOU MEDLINE INDUSTRY CO., LTD**” me përmbajtje si vijon si më poshtë vijon:

***Drejtuar: Firmës Prodhuese Syntesys SRL***

*Të nderuar,*

*Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimit, i cili shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, koncesionet/partneritetet publike private, ankandet dhe lejet minerare për operatorë ekonomikë vendas dhe të huaj.*

*Aktualisht, është duke shqyrtuar një ankesë, për “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-77239-08-10-2023, me objekt **Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje Tuba dhe Materiale konsumi laboratorike për nevoja të SRV” ndarë në 2 (dy) Lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, Loti 1 REF-77241-08-10-2023, Loti 1 “Blerje tubave/sistemeve të marrjes së gjakut” (në zbatim të kontratës koncesionare të laboratorëve), me fond limit Loti 1: 5,539,950 (Pesë milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.***

Komisioni i Prokurimit Publik, për shqyrtimin sa më të drejtë të kësaj ankese për procedurën e prokurimit të sipërcituar, kërkon informacion nga kompania juaj, si më poshtë vijon:

1. A është firma APTACA Spa e autorizuar nga ana juja për tregtuar produktet tuaja me kode 3530, 3540, 3550 dhe për të hartuar katalog për këto produkte?
2. A është e autorizuar nga ana juaj, firma APTACA Spa, për të lëshuar katalog për produktet me kodet 3530, 3540, 3550?
3. Cili është përdorimi i produktit me kodin 3540?

Me qëllim shqyrtimin në kohë të ankesës lutemi përgjigjen tuaj sa më shpejt të jetë e mundur.

**Drejtuar: Firmës Prodhuese HEINZ HERENZ MEDIZINALEDBARF GMBH**

Të nderuar,

Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimit, i cili shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, koncesionet/partneritetet publike private, ankandet dhe lejet minerare për operatorë ekonomikë vendas dhe të huaj.

Aktualisht, është duke shqyrtuar një ankesë, për “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. **REF-77239-08-10-2023**, me objekt **Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje Tuba dhe Materiale konsumi laboratorike për nevoja të SRV” ndarë në 2 (dy) Lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, Loti 1 REF-77241-08-10-2023, Loti 1 “Blerje tubave/sistemeve të marrjes së gjakut” (në zbatim të kontratës koncesionare të laboratorëve)**, me fond limit Loti 1: 5,539,950 (Pesë milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.

Komisioni i Prokurimit Publik, për shqyrtimin sa më të drejtë të kësaj ankese për procedurën e prokurimit të sipërcituar, kërkon informacion nga kompania juaj, si më poshtë vijon:

1. A është firma APTACA Spa e autorizuar nga ana juja për tregtuar produktin tuaj me kodin 1110104 dhe për të hartuar katalog për këtë produkt?
2. A është e autorizuar nga ana juaj, firma APTACA Spa, për të lëshuar katalog për produktin me kodin 1110104?
3. Cili është përdorimi i produktit me kodin 1110104?

Me qëllim shqyrtimin në kohë të ankesës lutemi përgjigjen tuaj sa më shpejt të jetë e mundur

**Drejtuar: Firmës Prodhuese YANGZHOU MEDLINE INDUSTRY CO., LTD**

Të nderuar,

Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimit, i cili shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, koncesionet/partneritetet publike private, ankandet dhe lejet minerare për operatorë ekonomikë vendas dhe të huaj.

Aktualisht, është duke shqyrtuar një ankesë, për “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. **REF-77239-08-10-2023**, me objekt **Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje Tuba dhe Materiale konsumi laboratorike për nevoja të SRV” ndarë në 2 (dy) Lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, Loti 1 REF-77241-08-10-2023, Loti 1 “Blerje tubave/sistemeve të marrjes së gjakut” (në zbatim të kontratës koncesionare të laboratorëve)**, me fond limit Loti 1: 5,539,950 (Pesë milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë

e nëntëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.

Komisioni i Prokurimit Publik, për shqyrtimin sa më të drejtë të kësaj ankese për procedurën e prokurimit të sipërcituar, kërkon informacion nga kompania juaj, si më poshtë vijon:

1. A është firma APTACA Spa e autorizuar nga ana juja për tregtuar produktet tuaja me kode SVS21G, SVS23G, HN22G32 dhe për të hartuar katalog për këto produkte?
2. A është e autorizuar nga ana juaj, firma APTACA Spa, për të lëshuar katalog për produktet me kodet SVS21G, SVS23G?
3. Cili është përdorimi i produkteve me kodet SVS21G, SVS23G, HN22G32?
4. Cili është roli i firmës RAYS Spa, në tregtimin dhe komercializimin e produkteve tuaja me kodet SVS21G, SVS23G, HN22G32?
5. Deklarata e Konformitetit (CE) për produktin “Intravenous needles for single use” i përket apo jo produktit me kodin HN22G32?

Me qëllim shqyrtimin në kohë të ankesës lutemi përgjigjen tuaj sa më shpejt të jetë e mundur.

II.5.9. Me memon e brendshme protokolluar me nr. 2481/6 prot., datë 02.11.2023, drejtuar kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik, me objekt “Kërkesë për përkthim”, u kërkua përkthimi në gjuhën angleze i përmbajtjes së mësipërme të shkresës, nga një përkthyes i licensuar, nga lista e përkthyesve zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë.

II.5.10. Me urdhrin nr. 2481/7 prot., datë 02.11.2023, u urdhërua përkthimi në gjuhën angleze i materialit të kërkuar me përmbajtjen si më lart, me objekt “Kërkesë për informacion”. Për këtë, KPP iu drejtua përkthyeses R.Ç, nga lista e përkthyesve zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë.

II.5.11. Me nr. 2481/8 prot., datë 02.11.2023, u nënshkrua kontrata “Kontratë shërbim përkthimi”, mes Komisionit të Prokurimit Publik dhe përkthyeses R.Ç.

II.5.12. Me procesverbalin me nr. 2481/9 prot., datë 03.11.2023, “Procesverbal i dorëzimit të materialit për përkthimin i materialit të kërkuar “Kërkesë për informacion”, iu bë dorëzimi i shkresës për përkthim përkthyeses R.Ç.

II.5.13. Me procesverbalin me nr. 2481/10 prot., datë 07.11.2023, “Procesverbal i marrjes në dorëzim të materialit, u bë marrja në dorëzim e shkresës së përkthyer në gjuhën angleze, nga lista e përkthyesve zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë.

II.5.14. Materiali i përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën angleze, iu drejtua përmes komunikimit elektronik zyrtar (e-mail) kompanive prodhuese “**Syntesys SRL**”, “**HEINZ HERENZ MEDIZINALEDBARF GMBH**” dhe “**YANGZHOU MEDLINE INDUSTRY CO., LTD**”.

II.5.15. Përmes komunikimit elektronik zyrtar kompania prodhuese “**Syntesys SRL**” me datë 09.11.2023, ka informuar KPP-në si më poshtë vijon:

*To Public Procurement Commission,*

*About the complaints on the “Open, simplified procedure with No. REF-77239-08-10-2023, with Object of the contract / Framework Agreement: "Purchase of Tubes and Laboratory Consumables for the needs of SRV" divided into 2 (two) Lots - Framework Agreement with several economic operators (a single EO successful for each lot) - where all the conditions are defined - with a term of 12 months”.*

*We answer as stated below:*

- 1. Is the APTACA Spa firm authorized by you to market your products with the codes 3530, 3540, 3550 and to create a catalog for these products?*

*Yes, we confirm that APTACA Spa is authorized to market our products with the codes 3530, 3540, 3550 and to create a catalog for these products in our behalf as stated in the “Authorization Letter” here attached.*

- 2. Is APTACA Spa authorized by you to issue a catalog for the products with codes 3530, 3540, 3550?*

*Yes, we confirm that APTACA Spa is authorized to issue a catalog for the products with codes 3530, 3540, 3550 in our behalf.*

- 3. What are the uses of product with the code 3540?*

*Code 3540 is referred to a product defined as tourniquet: a mechanical barrier for the compression of blood vessels during the venous sampling for subsequent diagnostic analysis, intravenous injections and / or a mechanical barrier upstream of the wounds to stop the hemorrhage/bleeding. For professional use only.*

*Hope this answer can fulfill the requirement to solve the complaint.*

*With respectful greetings*

II.5.16. Përmes komunikimit elektronik zyrtar kompania prodhuese “**HEINZ HERENZ MEDIZINALED BARF GMBH**” me datë 09.11.2023, ka informuar KPP-në si më poshtë vijon:

*Dear Sirs,*

*thank you for your Email and I hope everything is fine on your side.*

*To answer to your request:*

- 1. Yes, our long-term partner APTACA Spa is authorized sell and market our item 1110104 (blood lancet plastic, 23G)*
- 2. Yes, they are authorized to issue a catalogue for that item*
- 3. Attached to this Email, you will find our product description, (german and english)*

*I've snipped the part with the Intended use:*

*Hopefully these information are sufficient.*

*Best regards*

*Dirk Matzen*

*(Head of Export)*

**Heinz Herenz Medizinalbedarf GmbH**

*Rudorffweg 10-12*

*21031 Hamburg, Germany*

*Phone: +49-40-739204-13*

*Fax: +49-40-739204-39*



*E-Mail: dirk.matzen@herenz.de*

II.5.17. Me memon e brendshme protokolluar me nr. 2481/11 prot., datë 09.11.2023, drejtuar kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik, me objekt “Kërkesë për përkthim”, u kërkuar përkthimi në gjuhën shqipe i përmbajtjes së mësipërme të emaileve dhe shkresave bashkëlidhur secilit prej tyre, nga një përkthyes i licensuar, nga lista e përkthyesve zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë.

II.5.18. Me urdhrin nr. 24181/12 prot., datë 09.11.2023, u urdhërua përkthimi në gjuhën shqipe i materialit të kërkuar me përmbajtjen si më lartë. Për këtë, KPP iu drejtua përkthyeses R.Ç, nga lista e përkthyesve zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë.

II.5.19. Me nr. 2481/13 prot., datë 09.11.2023, u nënshkrua kontrata “Kontratë shërbim përkthimi”, mes Komisionit të Prokurimit Publik dhe përkthyeses R.Ç.

II.5.20. Me procesverbalin me nr. 2481/14 prot., datë 10.11.2023, “Procesverbal i dorëzimit të materialit për përkthimin i e-maileve respektive sëbashku me shkresën bashkëlidhur, iu bë dorëzimi i materialeve për përkthim përkthyeses R.Ç.

II.5.21. Me procesverbalin me nr. 2481/15 prot., datë 15.11.2023, “Procesverbal i marrjes në dorëzim të materialit, u bë marrja në dorëzim e “materialeve të përkthyer në gjuhën shqipe, nga lista e përkthyesve zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë.

II.6. Në datën 10.10.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi A/2023/3482 dhe me nr. 2481/2023 prot., datë 10.10.2023, e operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK për procedurën e prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK SHPK, si dhe me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin si edhe shtim të arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2481/2 prot., datë 11.10.2023 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK si dhe publikoi pretendimet e operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK që të mbetet i skualifikuar operatori ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK, si edhe të shtohen arsye të skualifikimit për mospërmbushje të kriterëve nga ky operator ekonomik.

II.6.2. Në datën 13.10.2023 është administruar Formulari i paraqitjes së argumenteve nga operatori ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 2481/3 prot., datë 13.10.2023.

II.6.3. Me anë të shkresës Nr.3993 prot., datë 11.10.2023, protokolluar pranë institucionit tonë me Nr.2481/4 prot., datë 13.10.2023 (ardhur me sistem) dhe me nr. 2481/5 prot., datë 17.10.2023, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimes “ALMedical” SHPK, në të cilën është vendosur **mospranimi i ankesës**.

II.6.4. Me shkresën nr. 4760 prot., datë 07.12.2023, protokolluar pranë institucionit tonë me Nr.2480/10 prot., datë 11.12.2023, autoriteti kontraktor informon, se ka vënë në dijeni të dy operatorët ekonomikë “Distributor of Medical Devices Group” SHPK dhe “ALMedical” SHPK, mbi vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të ankesave respektive për Lotin-1 dhe Lotin-2, shoqëruar me fotokopje të librit të protokollit.

II.6.5. Përmes komunikimit elektronik zyrtar, KPP iu drejtua me kërkesën për informacion kompanisë prodhuese “Zhejiang Gongdong Medical Technology Co., Ltd” me përmbajtje si vijon si më poshtë vijon:

***Drejtuar: Firmës Prodhuese Zhejiang Gongdong Medical Technology Co., Ltd***

*Të nderuar,*

*Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimit, i cili shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, koncesionet/partneritetet publike private, ankandet dhe lejet minerare për operatorë ekonomikë vendas dhe të huaj.*

*Aktualisht, është duke shqyrtuar një ankesë, për “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-77239-08-10-2023, me objekt **Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje Tuba dhe Materiale konsumi laboratorike për nevoja të SRV” ndarë në 2 (dy) Lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, Loti 1 REF-77241-08-10-2023, Loti 1 “Blerje tubave/sistemeve të marrjes së gjakut” (në zbatim të kontratës koncesionare të laboratorëve), me fond limit Loti 1: 5,539,950 (Pesë milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.***

*Komisioni i Prokurimit Publik, për shqyrtimin sa më të drejtë të kësaj ankese për procedurën e prokurimit të sipërcituar, kërkon informacion nga kompania juaj, si më poshtë vijon:*

- 1. A është firma APTACA Spa e autorizuar nga ana juja për tregtuar produktin tuaj me kodin W050101, GD-BF21G dhe për të hartuar katalog për këtë produkt?*
- 2. A është e autorizuar nga ana juaj, firma APTACA Spa, për të lëshuar katalog për produktin tuaj me kodin W050101 dhe GD-BF21G?*
- 3. Cili është përdorimi i produktit tuaj me kodin W050101 dhe GD-BF21G?*
- 4. Deklarata e Konformitetit (CE) e lëshuar nga ana juaj e përfshin produktin me kodin W050101 dhe GD-BF21G?*

II.6.6. Me memon e brendshme protokolluar me nr. 2481/6prot., datë 02.11.2023, drejtuar kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik, me objekt “Kërkesë për përkthim”, u kërkua përkthimi në gjuhën angleze i përmbajtjes së mësipërme të shkresës, nga një përkthyes i licensuar, nga lista e përkthyesve zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë.

II.6.7. Me urdhrin nr. 2481/7 prot., datë 02.11.2023, u urdhërua përkthimi në gjuhën angleze i materialit të kërkuar me përmbajtjen si më lartë, me objekt “Kërkesë për informacion”. Për këtë, KPP iu drejtua përkthyeses R.Ç, nga lista e përkthyesve zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë.

II.6.8. Me nr. 2481/8 prot., datë 02.11.2023, u nënshkrua kontrata “Kontratë shërbim përkthim”, mes Komisionit të Prokurimit Publik dhe përkthyeses R.Ç.

II.6.9. Me procesverbalin me nr. 2481/9 prot., datë 03.11.2023, “Procesverbal i dorëzimit të materialit për përkthimin i materialit të kërkuar “Kërkesë për informacion”, iu bë dorëzimi i shkresës për përkthim përkthyeses R.Ç.

II.6.10. Me procesverbalin me nr. 2481/10 prot., datë 07.11.2023, “Procesverbal i marrjes në dorëzim të materialit, u bë marrja në dorëzim e shkresës së përkthyer në gjuhën angleze, nga lista e përkthyesve zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë.

II.6.11. Materiali i përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën angleze, iu drejtua përmes komunikimit elektronik zyrtar (e-mail) kompanisë prodhuese “Zhejiang Gongdong Medical Technology Co., Ltd”.

II.6.12. Në mungesë të përgjigjes nga kompania Zhejiang Gongdong Medical Technology Co., Ltd, përmes komunikimit elektronik zyrtar, KPP i ridërgoi disa herë kërkesën për informacion kompanisë në fjalë, prej së cilës nuk mori asnjë përgjigje.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së vet, me argumentin, se “[...]Në këtë rast nuk bëhet lidhja midis certifikatës së konformitetit edhe artikujve

*Artikulli 11 “Zhgute (Ilastik) për shtrëngimin e krahut ku do të merret gjaku se kompania prodhuese është kompania Syntesys srl por certifikata e konformitetit është për tuba dhe jo për zhgut. Katalogu është i kompanisë APTACA dhe produkti është produkt i prodhuar nga*

kompania APTACA dhe jo nga kompania Syntesys srl”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.3 dhe 2.3.7 “Kapaciteti teknik”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

**Për secilin lot**

2.3.3. Vetedeklarim se të gjitha materialet mjekësore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) të jenë të certifikuara ose markuara CE ose FDA, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave”.

2.3.7. Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohe, nese nuk janë në gjuhën shqipe, te perktthehen në gjuhën shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet te markoje në katalogun perkates produktet që ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar në formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem në formë elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit. **Per secilin lot**

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK, rezulton, se ka paraqitur në SPE, në përmbushje të kriterit të sipërcituar:

-Deklaratë origjine për produktet e ofruara me datë 25.09.2023.

-Deklaratë me datë 25.09.2023 se të gjitha materialet mjekësore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) të jenë të certifikuara ose markuara CE ose FDA, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave.

-Autorizim nga firma Aptica Spa, të cilët jemi prodhues zyrtarë të artikujve laboratorikë, për operatorin ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK, me datë 13.09.2023, se është distributor i autorizuar për të ofruar dhe promovuar gamën e produkteve, për të marrë pjesë në tendera, për të paraqitur oferta për produktin tonë, për të negociuar dhe nënshkruar kontrata me institucione publike dhe subjekte private për të regjistruar, importuar, shpërndarë mallrat e prodhuara nga kompania jonë brenda territorit të Shqipërisë;

-Letër autorizimi me datë 13.09.2023 nga Syntesys Srl, prodhues i pajisjeve mjekësore të klasit të I, në përputhje me Rregulloren Mjekësore 2017/745 dhe importuesi/shpërndarësi i klasit I në përputhje me 93/42/CE, i cili autorizon Aptica Spa për të shitur, komercializuar dhe promovuar kodet e produkteve 3530, 3540 dhe 3550.

-Deklaratë e konformitetit CE të prodhuesit Syntesys Srl me datë 05.09.2023.

-Katalog në gjuhën e huaj anglisht dhe italisht, i përkthyer në gjuhën shqipe, në të cilin është markuar edhe artikulli nr. 11 llastik me kodin 3540.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

*Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikon se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

*Në nenin Neni 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:*

*1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.*

*2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.*

*3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në*

*njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*

*Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.*

III.1.4. Në nenin 82, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: “1. Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 20 (njëzet) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuar ndryshe në këto rregulla. Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve”.

Në nenin 40, pika 6 dhe 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

III.1.5. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët

ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë, se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik duhet të paraqesë: *2.3.3. Vetedeklarim se të gjitha materialet mjekesore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) të jenë të certifikuara ose markuara CE ose FDA, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave.*

*2.3.7. Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej, nese nuk janë në gjuhën shqipe, të perkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. **Per secilin lot***

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues “*Distributor of Medical Devices Group*” SHPK, konstatohet, se ky i fundit për artikullin nr. 11 i cili është edhe objekt i ankesës, ka paraqitur deklaratën e konformitetit (CE) të prodhuesit Syntesys Srl në të cilin është cituar produkti me kodin 3540, Letër autorizimi të lëshuar nga prodhuesi Syntesys Srl për Aptica Spa, si dhe Katalogun i cili nuk është i kompanisë prodhuese Syntesys Srl por është i kompanisë Aptica Spa, në gjuhën e huaj anglisht



dhe italisht, i përkthyer në gjuhën shqipe, në të cilin është markuar edhe artikulli nr. 11 llastik, me kodin 3540, të ngarkuar në SPE.

Duke marrë shkas nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Distributor of Medical Devices Group*” SHPK, si dhe arsyes së skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik gjatë hetimit administrativ gjykoi së pari të kryente një hetim të thelluar administrativ mbi vlefshmërinë e dokumentit “Letër autorizimi” dhe përmbajtjes së tij, i lëshuar nga kompania Syntesys Srl, një subjekt juridik i regjistruar dhe themeluar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. E-mail i përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën angleze, nga përkthyesi R.Ç, marrë nga lista e përkthyesve zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar (e-mail), duke filluar nga data 02.11.2023 e deri në datën 09.11.2023, me kërkesën për informacion në mënyrë të përmbledhur si vijon:

1. *A është firma APTACA Spa e autorizuar nga ana juaj për tregtuar produktet tuaja me kode 3530, 3540, 3550 dhe për të hartuar katalog për këto produkte?*
2. *A është e autorizuar nga ana juaj, firma APTACA Spa, për të lëshuar katalog për produktet me kodet 3530, 3540, 3550?*
3. *Cili është përdorimi i produktit me kodin 3540?*

Në përgjigje të kërkesës së KPP-së, email-i dërguar në adresën elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik në datën 09.11.2023, nga kompania “Syntesys Srl”, sipas të cilit Komisioni i Prokurimit Publik informohet se: “*To Public Procurement Commission, About the complaints on the “Open, simplified procedure with No. REF-77239-08-10-2023, with Object of the contract / Framework Agreement: "Purchase of Tubes and Laboratory Consumables for the needs of SRV" divided into 2 (two) Lots - Framework Agreement with several economic operators (a single EO successful for each lot) - where all the conditions are defined - with a term of 12 months”.*

*We answer as stated below:*

2. *Is the APTACA Spa firm authorized by you to market your products with the codes 3530, 3540, 3550 and to create a catalog for these products?*

*Yes, we confirm that APTACA Spa is authorized to market our products with the codes 3530, 3540, 3550 and to create a catalog for these products in our behalf as stated in the “Authorization Letter” here attached.*

3. *Is APTACA Spa authorized by you to issue a catalog for the products with codes 3530, 3540, 3550?*

*Yes, we confirm that APTACA Spa is authorized to issue a catalog for the products with codes 3530, 3540, 3550 in our behalf.*

4. *What are the uses of product with the code 3540?*

*Code 3540 is referred to a product defined as tourniquet: a mechanical barrier for the compression of blood vessels during the venous sampling for subsequent diagnostic analysis, intravenous injections and / or a mechanical barrier upstream of the wounds to stop the hemorrhage/bleeding. For professional use only.*

*Hope this answer can fulfill the requirement to solve the complaint.*

*With respectful greetings”.*

Duke marrë shkas nga kthim-përgjigjja e sipërcituar, administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni gjykon, se me

dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “*Distributor of Medical Devices Group*” SHPK, përmbush kriteret e përcaktuara në pikat 2.3.3 dhe 2.3.7 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-shqyrtimi, për arsye se siç njofton vetë shoqëria “Syntesys Srl”, kjo e fundit është prodhuese e pajisjeve mjekësore të klasit të I, në përputhje me Rregulloren Mjekësore 2017/745 dhe importuesi/shpërndarësi i klasit I në përputhje me 93/42/CE, i cili autorizon Aptica Spa për të shitur, komercializuar dhe promovuar kodet e produkteve 3530, 3540 dhe 3550, përfshirë edhe llojin e artikullit nr. 11 (zhgut/llastik), me të cilin operatori ekonomik ankimes ka ofertuar në këtë procedurë prokurimi, të cilët tashmë shiten nën markën e Aptica Spa dhe në mënyrë të qartë dhe shteruese ka konfirmuar se Aptica Spa është distributor i autorizuar për produktet me kodet 3530, 3540 dhe 3550, si dhe sipas saj distributori i autorizuar për të shitur, komercializuar dhe promovuar këto produkte si dhe për të hartuar katalog për këto produkte. Duke qenë se operatori ekonomik “*Distributor of Medical Devices Group*” SHPK ka ofertuar për artikullin nr. 11 (zhgut/llastik) me kodin 3540, përkufizimi dhe përdorimi i të cilit është sqaruar nga kompania prodhuese Syntesys Srl, i cili sipas shënimeve në katalog i përket firmës Aptica Spa, e cila është gjithashtu e autorizuar nga prodhuesi Syntesys srl për të lëshuar katalogë për artikullin nr. 11 të markuar me kodin 3540, Komisioni, do të konsiderojë si të vlefshme deklaratimet e këtij të fundit në cilësinë e distributor të autorizuar. Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me *lex specialis*.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “*Distributor of Medical Devices Group*” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “*Distributor of Medical Devices Group*” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së vet, me argumentin, se “[...]Artikullin 10 “*Gjilpërë shpuese për marrjen e gjakut të foshnjës (lancet)*”

*kompania prodhuese është kompania gjermane Heinz Herenz Medizinalbedarf GmbH dhe deklarata CE e konformitetit është për produktin e prodhuar prej saj,*

*Ndërkohë në katalog është paraqitur për këtë artikull katalogu i firmës APTACA edhe pse kompania gjermane ka lëshuar autorizim prodhuesi për firmën APTACA*

*ky autorizim deklaron se APTACA do të shes, komercializuar dhe promovuar produktet e tij pra nuk deklaron se ky produkt me markën APTACA janë produkte të prodhuara nga kompanie Heinz Herenz Medizinalbedarf GmbH”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.3.7 “*Kapaciteti teknik*”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

***Për secilin lot***

2.3.3. *Vetedeklarim se të gjitha materialet mjekësore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) të jenë të certifikuara ose markuara CE ose FDA, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave*

*përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave”.*

*2.3.7. Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjeset e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nese nuk janë në gjuhën shqipe, te përkthehen në gjuhën shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit. **Për secilin lot***

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK, rezulton, se ka paraqitur në SPE, në përmbushje të kriterit të sipërcituar:

-Deklaratë origjine për produktet e ofruara me datë 25.09.2023.

-Deklaratë me datë 25.09.2023 se të gjitha materialet mjekësore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) të jenë të certifikuara ose markuara CE ose FDA, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave.

-Autorizim nga firma Aptica Spa, të cilët jemi prodhues zyrtarë të artikujve laboratorikë, për operatorin ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK, me datë 13.09.2023, se është distributor i autorizuar për të ofruar dhe promovuar gamën e produkteve, për të marrë pjesë në tendera, për të paraqitur oferta për produktin tonë, për të negociuar dhe nënshkruar kontrata me institucione publike dhe subjekte private për të regjistruar, importuar, shpërndarë mallrat e prodhuara nga kompania jonë brenda territorit të Shqipërisë;

-Letër autorizimi me datë 06.09.2023 nga Heinz Herenz Medizinalbedarf GmbH, importues/shpërndarës i pajisjeve mjekësore të klasit të I, në përputhje me Rregulloren 2017/745 të Pajisjeve Mjekësore dhe prodhues i klasit Is dhe Iia në përputhje me 93/42/CEE, i cili autorizon Aptica Spa për të shitur, komercializuar dhe promovuar produktet me kod 1110104-Lancet gjaku i përshtatshëm për pajisje standarde, sterile, plastike, gjilpërë ss 23G, 100/kuti.

-Deklaratë e konformitetit CE të prodhuesit Heinz Herenz Medizinalbedarf GmbH me datë 25.06.2020.

-Katalog në gjuhën e huaj anglisht dhe italisht, i përkthyer në gjuhën shqipe, në të cilin është markuar edhe artikulli nr. 10 gjilpërë shpuese për marrjen e gjakut të foshnjave (lancet) me kodin 5105.

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

*Qëllim i këtij ligji është:*

*a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*

*b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*

*c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*

- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikon se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.*

*2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.*

*3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*

*Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.*

III.2.4. Në nenin 82, pika 1 të VKM nr. 285, datë “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: “1. Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 20 (njëzet) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuar ndryshe në këto rregulla. Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve”.

Në nenin 40, pika 6 dhe 8 të VKM nr. 285, datë “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

III.2.5. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin

e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.2.6. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë, se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik duhet të paraqesë: *2.3.3. Vetedeklarim se të gjitha materialet mjekësore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) të jenë të certifikuara ose markuara CE ose FDA, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave.*

*2.3.7. Për të gjithë artikujt e ofruar të paraqiten katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej, nese nuk janë në gjuhën shqipe, të perkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të percaktuar në formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. **Për secilin lot***

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues “*Distributor of Medical Devices Group*” SHPK, konstatohet, se ky i fundit për artikullin nr. 10 i cili është edhe objekt i ankesës, ka paraqitur deklaratën e konformitetit (CE) të prodhuesit Heinz Herenz Medizinalbedarf GmbH, në të cilin është cituar produkti me kodin 1110104, Letër autorizimi të lëshuar nga prodhuesi Heinz Herenz Medizinalbedarf GmbH për Aptica Spa, si dhe Katalogun i cili nuk është i kompanisë prodhuese Heinz Herenz Medizinalbedarf GmbH, por është i kompanisë Aptica Spa, në gjuhën e huaj anglisht dhe italisht, i përkthyer në gjuhën shqipe, në të cilin është markuar edhe artikulli nr. 10 gjilpërë shpuese për marrjen e gjakut të foshnjave (lancet) me kodin 5105, të ngarkuar në SPE. Duke marrë shkas nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Distributor of Medical Devices Group*” SHPK si dhe arsyes së skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik gjatë hetimit administrativ gjykoi së pari të kryente një hetim të thelluar administrativ mbi vlefshmërinë e dokumentit “Letër autorizimi” dhe përmbajtjes së tij, i lëshuar

nga kompania Heinz Herenz Medizinalbedarf GmbH, një subjekt juridik i regjistruar dhe themeluar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. E-mail i përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën angleze, nga përkthyesi R.Ç, marrë nga lista e përkthyesve zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar (e-mail), duke filluar nga data 02.11.2023 e deri në datën 09.11.2023, me kërkesën për informacion në mënyrë të përmbledhur si vijon:

1. A është firma APTACA Spa e autorizuar nga ana juja për tregtuar produktin tuaj me kodin 1110104 dhe për të hartuar katalog për këtë produkt?
2. A është e autorizuar nga ana juaj, firma APTACA Spa, për të lëshuar katalog për produktin me kodin 1110104?
3. Cili është përdorimi i produktit me kodin 1110104?

Në përgjigje të kërkesës së KPP-së, email-i dërguar në adresën elektronike të Komisionit të Prokurimit Publik në datën 09.11.2023 nga kompania “Heinz Herenz Medizinalbedarf GmbH”, sipas të cilit Komisioni i Prokurimit Publik informohet se: “Dear Sirs, thank you for your Email and I hope everything is fine on your side.

*To answer to your request:*

1. Yes, our long-term partner APTACA Spa is authorized sell and market our item 1110104 (blood lancet plastic, 23G)
2. Yes, they are authorized to issue a catalogue for that item
3. Attached to this Email, you will find our product description, (german and english)

*I've snipped the part with the Intended use:*

*Hopefully these information are sufficient.*

*Best regards*

*Dirk Matzen*

*(Head of Export)*

**Heinz Herenz Medizinalbedarf GmbH**

*Rudorffweg 10-12*

*21031 Hamburg, Germany*

*Phone: +49-40-739204-13*

*Fax: +49-40-739204-39*

*E-Mail: dirk.matzen@herenz.de”.*

Duke marrë shkas nga kthim-përgjigjja e sipërcituar, administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni gjykon, se me dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK, përmbush kriteret e përcaktuara në pikat 2.3.3 dhe 2.3.7 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-shqyrtimi, për arsye se siç njofton vetë shoqëria “Heinz Herenz Medizinalbedarf GmbH”, kjo e fundit është importues/shpërndarës i pajisjeve mjekësore të klasit të I, në përputhje me Rregulloren 2017/745 të Pajisjeve Mjekësore dhe prodhues i klasit Is dhe Iia në përputhje me 93/42/CEE, i cili autorizon Aptica Spa për të shitur, komercializuar dhe promovuar produktet me kod 1110104-Lancet gjaku i përshtatshëm për pajisje standarde, sterile, plastike, gjilpërë ss 23G, 100/kuti, i cili autorizon Aptica Spa për të shitur, komercializuar dhe promovuar produktet me kod 1110104-Lancet gjaku i përshtatshëm për pajisje standarde, sterile, plastike, gjilpërë ss 23G, 100/kuti, përfshirë edhe llojin e artikullit nr. 10 (gjilpërë shpuese për marrjen e gjakut të foshnjave (lancet) me kodin 5105), me të cilin



operatori ekonomik ankimues ka ofertuar në këtë procedurë prokurimi, të cilat tashmë shiten nën markën e Aptica Spa dhe në mënyrë të qartë dhe shteruese ka konfirmuar se Aptica Spa është distributor i autorizuar për produktet me kod 1110104-Lancet gjaku i përshtatshëm për pajisje standarde, sterile, plastike, gjilpërë ss 23G, 100/kuti, si dhe sipas saj distributori i autorizuar për të shitur, komercializuar dhe promovuar këto produkte si dhe për të hartuar katalog për këto produkte. Duke qenë se operatori ekonomik “*Distributor of Medical Devices Group*” SHPK ka ofertuar për artikullin nr. 10 (gjilpërë shpuese për marrjen e gjakut të foshnjave (lancet) me kodin 5105, përkufizimi dhe përdorimi i të cilët është sqaruar nga kompania prodhuese Heinz Herenz Medizinalbedarf GmbH, i cili sipas shënimeve në katalog i përket firmës Aptica Spa, e cila është gjithashtu e autorizuar nga prodhuesi Heinz Herenz Medizinalbedarf GmbH për të lëshuar katalogë për produktet me kod 1110104-Lancet gjaku i përshtatshëm për pajisje standarde, sterile, plastike, gjilpërë ss 23G, 100/kuti, përfshirë edhe llojin e artikullit nr. 10 (gjilpërë shpuese për marrjen e gjakut të foshnjave (lancet) me kodin 5105, Komisioni do të konsiderojë si të vlefshme deklaratimet e këtij të fundit në cilësinë e distributor të autorizuar. Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me *lex specialis*.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “*Distributor of Medical Devices Group*” SHPK qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “*Distributor of Medical Devices Group*” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së vet, me argumentin, se “[...]edhe për artikullin e mëposhtëm është paraqit deklarata e origjinës së mallit e një kompanie edhe katalogu i një firme tjetër si më poshtë :

→ Artikullin 13 “*Age flutur për marrjen e gjakut “se kompania prodhuese është kompania kineze Yangzhou Medline Industry Co.Ltd. për të cilën ka paraqitur edhe certifikatën e konformitetit por katalogu është paraqitur i firmës APTACA.*

→ Kompania kineze ka lëshuar autorizim prodhuesi për firmën APTACA ky autorizim deklaroi se APTACA do të shes, komercializuar dhe promovuar produktet e tij, dhe jo të deklaroj se ky produkt me markën APTACA janë produkte të prodhuara nga kompania Yangzhou Medline Industry. Nuk ka dokumentacion që verteton lidhjen midis kompanisë RAYS“ me kompaninë kineze Yangzhou Medline Industry”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.3.7 “*Kapaciteti teknik*”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

***Për secilin lot***

2.3.3. *Vetedeclarim se të gjitha materialet mjekesore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) të jenë të certifikuar ose markuara CE ose FDA, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave*

*përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave”.*

*2.3.7. Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nese nuk janë në gjuhën shqipe, te përkthehen në gjuhën shqipe dhe te noterizohen). Operatori ekonomik duhet te markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit. **Për secilin lot***

III.3.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK, rezulton, se ka paraqitur në SPE, në përmbushje të kriterit të sipërcituar:

- Deklaratë origjine për produktet e ofruara me datë 25.09.2023.
- Deklaratë me datë 25.09.2023 se të gjitha materialet mjekësore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) të jenë të certifikuara ose markuara CE ose FDA, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave.
- Autorizim nga firma Aptica Spa, të cilët jemi prodhues zyrtarë të artikujve laboratorikë, për operatorin ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK, me datë 13.09.2023, se është distributor i autorizuar për të ofruar dhe promovuar gamën e produkteve, për të marrë pjesë në tendera, për të paraqitur oferta për produktin tonë, për të negociuar dhe nënshkruar kontrata me institucione publike dhe subjekte private për të regjistruar, importuar, shpërndarë mallrat e prodhuara nga kompania jonë brenda territorit të Shqipërisë;
- Letër autorizimi me datë 3.09.2023 nga YANGZHOU MEDLINE INDUSTRY CO., LTD, prodhues i pajisjeve mjekësore të klasit IIa, në përputhje me 93/42/CEE, i cili autorizon Aptica Spa për të shitur, komercializuar dhe promovuar produktin e mëposhtëm të importuar nga Rays Spa, komplete sterile të venave të kokës, kodet e artikujve SVS21G dhe SVS23G dhe për të mbajtur një magazinë për të garantuar një furnizim të vazhdueshëm të produkteve tona në territorin e Italisë dhe jashtë saj.
- Deklaratë e konformitetit CE të prodhuesit YANGZHOU MEDLINE INDUSTRY CO., LTD me datë 11.05.2020.
- Katalog në gjuhën e huaj anglisht dhe italisht, i përkthyer në gjuhën shqipe, në të cilin është markuar edhe artikulli nr. 13 Age flutur për marrjen e gjakut me kodin 3141, tipi 21G.

III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

*Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*

- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikon se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.*

*2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.*

*3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*

*Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.*

III.3.4. Në nenin 82, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: “1. Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 20 (njëzet) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuar ndryshe në këto rregulla. Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve”.

Në nenin 40, pika 6 dhe 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

III.3.5. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin

e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.3.6. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë, se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik duhet të paraqesë: *2.3.3. Vetedeklarim se të gjitha materialet mjekësore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) të jenë të certifikuara ose markuara CE ose FDA, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave.*

*2.3.7. Për të gjithë artikujt e ofruar te paraqiten katalogje, ku te përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej, nese nuk janë në gjuhën shqipe, të perkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit. Për secilin lot.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues “Distributor of Medical Devices Group” SHPK, konstatohet, se ky i fundit për artikullin nr. 13 i cili është edhe objekt i ankesës, ka paraqitur deklaratën e konformitetit (CE) të prodhuesit YANGZHOU MEDLINE INDUSTRY CO., LTD në të cilin është cituar produkti me kodin SVS21G, Letër autorizimi me datë 3.09.2023 nga YANGZHOU MEDLINE INDUSTRY CO., LTD, prodhues i pajisjeve mjekësore të klasit IIa, në përputhje me 93/42/CEE, i cili autorizon Aptica Spa për të shitur, komercializuar dhe promovuar produktin e mëposhtëm të importuar nga Rays Spa, komplete sterile të venave të kokës, kodet e artikujve SVS21G dhe SVS23G dhe për të mbajtur një magazinë për të garantuar një furnizim të vazhdueshëm të produkteve tona në territorin e Italisë dhe jashtë saj si dhe Katalogun i cili nuk është i kompanisë prodhuese YANGZHOU MEDLINE INDUSTRY CO., LTD por është i kompanisë Aptica Spa, në gjuhën e huaj anglisht dhe italisht, i përkthyer në gjuhën shqipe, në të cilin është markuar edhe artikulli nr. 13 Age flutur për marrjen e gjakut me kodin 3141, tipi

21G, të ngarkuar në SPE. Duke marrë shkas nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Distributor of Medical Devices Group*” SHPK si dhe arsyes së skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik gjatë hetimit administrativ gjykoi së pari të kryente një hetim të thelluar administrativ mbi vlefshmërinë e dokumentit “Letër autorizimi” dhe përmbajtjes së tij, i lëshuar nga kompania YANGZHOU MEDLINE INDUSTRY CO., LTD, një subjekt juridik i regjistruar dhe themeluar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. E-mail i përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën angleze, nga përkthyesi R.Ç, marrë nga lista e përkthyesve zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar (e-mail), duke filluar nga data 02.11.2023, me kërkesën për informacion në mënyrë të përmbledhur si vijon:

1. A është firma APTACA Spa e autorizuar nga ana juja për tregtuar produktet tuaja me kode SVS21G, SVS23G, HN22G32 dhe për të hartuar katalog për këto produkte?
2. A është e autorizuar nga ana juaj, firma APTACA Spa, për të lëshuar katalog për produktet me kodet SVS21G, SVS23G?
3. Cili është përdorimi i produkteve me kodet SVS21G, SVS23G, HN22G32?
4. Cili është roli i firmës RAYS Spa, në tregtimin dhe komercializimin e produkteve tuaja me kodet SVS21G, SVS23G, HN22G32?
5. Deklarata e Konformitetit (CE) për produktin “*Intravenous needles for single use*” i përket apo jo produktit me kodin HN22G32?

Edhe pas kërkesave të vazhdueshme të KPP-së për informacion nga kompania YANGZHOU MEDLINE INDUSTRY CO., LTD, kjo e fundit nuk dha asnjë përgjigje.

Komisioni i Prokurimit Publik i ndodhur përpara këtij fakti edhe pas ezaurimit të të gjitha veprimeve procedurale që parashikon ligji dhe rregullat e prokurimit publik, nuk mund të shprehet dhe të marrë në shqyrtim pretendimin e operatori ekonomik ankimues “*Distributor of Medical Devices Group*” SHPK, në lidhje me këtë pikë. Në këto kushte, autoriteti kontraktor duhet të zbatojë parashikimet e nenit 82, pika 1, paragrafi i dytë, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, ku përcaktohet shprehimisht se: “*Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve*”, pasi referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, veprimeve procedurale të kryera nga KPP në parashikim të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, si dhe mungesës së përgjigjes nga kompania prodhuese, autoriteti kontraktor në cilësinë e organit i cili e shqyrton së pari ankesën ndodhet përballë nevojës për të kryer verifikime të mëtejshme në lidhje me pretendimet më sipër.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së vet, me argumentin, se “[...]Në CE e konformitetit të kompanisë prodhuese ZheJiang Gongdong Medical Technology Co.Ltd nuk është e përfshirë artikulli Set age për marrjen e gjakut”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 7 “*Kriteret e veçanta të kualifikimit*”, pika 2.3.3 “*Kapaciteti teknik*”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

2.3.3. *Vetedeklarim se te gjitha materialet mjekesore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) te jene te certifikuara ose markuara CE ose FDA, kur eshte e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Keshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të perkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave.*

***Per secilin lot***

III.4.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK, rezulton, se ka paraqitur në SPE, në përmbushje të kriterit të sipërcituar:

-Deklaratë me datë 25.04.2023, nga Zhejiang Gongdong Medical Technology Co., Ltd, prodhues zyrtar i materialeve laboratorike konsumi, i cili deklaron se gjilpërat flutur me kodin GD-BF21G plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara: gjatësia e tubit është 300mm, gjatësia e gjilpërës është 19mm.

-Letër autorizimi nga Zhejiang Gongdong Medical Technology Co., Ltd, prodhues zyrtar i sistemit të tubave të gjakut, i cili autorizon “ALMedical” SHPK për të ofertuar, negociuar dhe lidhur kontratën me çdo institucion, subjekt etj. në zonën e Shqipërisë për mallrat e prodhuar nga ne.

-Deklaratë e konformitetit BE të prodhuesit Zhejiang Gongdong Medical Technology Co., Ltd me datë 11.0.2023, në të cilën citohet emri i produktit “Tub gjaku me vakum njëpërdorimësh, kodi i produktit IVR 0801 dhe kodi EMDN E050101.

-Katalog në gjuhën e huaj anglisht, i përkthyer në gjuhën shqipe, “Sistemi i mbledhjes së gjakut me vakum, në të cilin është markuar edhe artikulli nr. 8.

III.4.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

*Qëllim i këtij ligji është:*

*a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*

*b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*

*c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*

*ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*

*d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*

*dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikon se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në



*dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

2. *Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.*

*Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

4. *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.*

*2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.*

*3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.*

*Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.*

III.4.4. Në nenin 82, pika 1 të VKM nr. 285, datë datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: “1. Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 20 (njëzet) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuar ndryshe në këto rregulla. Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve”.

Në nenin 40, pika 6 dhe 8 të VKM nr. 285, datë datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

*“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

*8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”*

III.4.5. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi

vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.4.6. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë, se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik duhet të paraqesë: *2.3.3. Vetedeklarim se të gjitha materialet mjekesore nga ofertuesi (distributori/prodhuesi) të jenë të certifikuara ose markuara CE ose FDA, kur është e aplikueshme, sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) ose FDA, origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit të ofertave.*

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues “ALMedical” SHPK, konstatohet, se ky i fundit për artikullin nr. 8 i cili është edhe objekt i ankesës, ka paraqitur Deklaratë e konformitetit BE të prodhuesit Zhejiang Gongdong Medical Technology Co., Ltd me datë 11.0.2023, në të cilën citohet emri i produktit “Tub gjaku me vakum njëpërdorimësh, kodi i produktit IVR 0801 dhe kodi EMDN E050101, Letër autorizimi nga Zhejiang Gongdong Medical Technology Co., Ltd, prodhues zyrtar i sistemit të tubave të gjakut, i cili autorizon “ALMedical” SHPK për të ofertuar, negociuar dhe lidhur kontratën me çdo institucion, subjekt etj në zonën e Shqipërisë për mallrat e prodhuar nga ky i fundit si dhe Katalog në gjuhën e huaj anglisht, i përkthyer në gjuhën shqipe, në të cilin është markuar edhe artikulli nr. 8 Set Age për marrje gjaku, të përshtatshme për të gjithë tubat e sistemit me vakum të ofruar, të ngarkuar në SPE. Duke marrë shkas nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “ALMedical” SHPK si dhe arsyes së skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik gjatë hetimit administrativ gjykoi së pari të kryente një hetim të thelluar administrativ mbi vlefshmërinë e dokumentit deklaratën e konformitetit (BE) të prodhuesit Zhejiang Gongdong Medical Technology Co., Ltd, një subjekt juridik i regjistruar dhe themeluar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. E-mail i përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën angleze, nga përkthyesi R.Ç, marrë nga lista e përkthyesve zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar (e-mail), duke filluar nga data 02.11.2023, me kërkesën për informacion në mënyrë të përmbledhur si vijon:

***Drejtuar: Firmës Prodhuese Zhejiang Gongdong Medical Technology Co., Ltd***

*Të nderuar,*

*Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimit, i cili shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, koncesionet/partneritetet publike private, ankandet dhe lejet minerare për operatorë ekonomikë vendas dhe të huaj.*

*Aktualisht, është duke shqyrtuar një ankesë, për “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-77239-08-10-2023, me objekt **Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje Tuba dhe Materiale konsumi laboratorike për nevoja të SRV” ndarë në 2 (dy) Lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, Loti 1 REF-77241-08-10-2023, Loti 1 “Blerje tubave/sistemeve të marrjes së gjakut” (në zbatim të kontratës koncesionare të laboratorëve), me fond limit Loti 1: 5,539,950 (Pesë milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë***

*e nëntëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.*

*Komisioni i Prokurimit Publik, për shqyrtimin sa më të drejtë të kësaj ankese për procedurën e prokurimit të sipërcituar, kërkon informacion nga kompania juaj, si më poshtë vijon:*

- 1. A është firma APTACA Spa e autorizuar nga ana juja për tregtuar produktin tuaj me kodin W050101, GD-BF21G dhe për të hartuar katalog për këtë produkt?*
- 2. A është e autorizuar nga ana juaj, firma APTACA Spa, për të lëshuar katalog për produktin tuaj me kodin W050101 dhe GD-BF21G?*
- 3. Cili është përdorimi i produktit tuaj me kodin E050101 dhe GD-BF21G?*
- 4. Deklarata e Konformitetit (CE) e lëshuar nga ana juaj e përfshin produktin me kodin E050101 dhe GD-BF21G?*

Materiali i përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën angleze, iu drejtua përmes komunikimit elektronik zyrtar (e-mail) kompanisë prodhuese “Zhejiang Gongdong Medical Technology Co., Ltd”. Në mungesë të përgjigjes nga kompania “Zhejiang Gongdong Medical Technology Co., Ltd, përmes komunikimit elektronik zyrtar, KPP i ridërgoi disa herë kërkesën për informacion kompanisë në fjalë, prej së cilës nuk mori asnjë përgjigje.

Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, veprimeve procedurale të kryera nga KPP në parashikim të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, si dhe mungesës së përgjigjes nga kompania prodhuese, pretendimeve të operatorit ekonomik ankimes, Komisioni gjykon, se me dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “ALMedical” SHPK, ky i fundit nuk i përmbush kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.3, të dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-shqyrtimi, për arsye se në dokumentin e Deklaratës së konformitetit BE të prodhuesit Zhejiang Gongdong Medical Technology Co., Ltd me datë 11.0.2023, KPP konstaton, se në këtë dokument të përkthyer nga gjuha e huaj anglisht në gjuhën shqipe, citohet emri i produktit “Tub gjaku me vakum njëpërdorimsh, kodi i produktit IVR 0801 dhe kodi EMDN W050101 nga kompania prodhuese “Zhejiang Gongdong Medical Technology Co., Ltd, i cili është prodhues zyrtar i materialeve laboratorike konsumi. Duke qenë se operatori ekonomik “ALMedical” SHPK ka ofertuar për artikullin nr. 8 shoqëruar me dokumentacion “Deklaratës së konformitetit BE” të prodhuesit Zhejiang Gongdong Medical Technology Co., Ltd, në të cilin citohet emri i produktit “Tub gjaku me vakum njëpërdorimsh, kodi i produktit IVR 0801 dhe kodi EMDN W050101, ndërkohë referuar emërtimit të artikullit me nr.8 “ Set Age per marrje gjaku, të përshtatshme për të gjitha tubat e sistemit me vakum të ofruar” nuk përputhet me emërtimin e produktit të deklaruar në dokumentin e “Deklaratës së konformitetit BE” nga kompania prodhuese “Zhejiang Gongdong Medical Technology Co., Ltd.

Sa më sipër, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik “ALMedical” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.3 të kriteve të veçanta të kualifikimit “kapaciteti teknik” të dokumenteve të tenderit. Bazuar në sa më sipër, KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti

kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me lex specialis.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “ALMedical” ShPK nuk qëndron.

III.5. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “ALMedical” ShPK për *lënien të skualifikuar si edhe shtim të arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK,*

Në ato raste, kur operatori ekonomik ankimues “ALMedical” ShPK edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë që ka paraqitur ankimin, vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, i drejtpërdrejtë e real (përkundrejt atij imagjinar), nuk ka se si të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi. Për sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk do të merret në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. **REF-77239-08-10-2023**, me objekt **Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje Tuba dhe Materiale konsumi laboratorike për nevoja të SRV” ndarë në 2 (dy) Lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, Loti 1 REF-77241-08-10-2023, Loti 1 “Blerje tubave/sistemeve të marrjes së gjakut” (në zbatim të kontratës koncesionare të laboratorëve), me fond limit Loti 1: 5,539,950 (Pesë milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.**

2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK, të korrigojë shkeljet e konstatuara, si dhe të kryejë veprimet procedurale në lidhje me zbatimin e konstatimeve të më sipërm.
  3. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ALMedical” SHPK për procedurën e prokurimit më sipërcituar.
  4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK.
  6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifave financiare të paguara nga operatori ekonomik “ALMedical” SHPK.
  7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**

**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**

**Anila Malaj**

**Kryetar**

**Jonaïd Myzyri**

